VENDIM
Nr. 495, datë 21.10.2020

PËR KRIJIMIN E NJËSIVE TË SHËRBIMIT LIGJOR PRANË GJYKATAVE TË APELIT

Mbështetur në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenin 61, pika 2/ë, 94, pika 3, dhe 97, pika 1/c, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar; në nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli i Lartë Gjyqësor

VENDOSI:

1. Krijimin e "Njësisë së Shërbimit Ligjor", si pjesë e strukturës së gjykatave të apelit, me organikë si më poshtë:

a) Gjykata e Apelit Tiranë – 15 ndihmës ligjorë;
b) Gjykata e Apelit Durrës – 6 ndihmës ligjorë;
c) Gjykata e Apelit Gjirokastër – 3 ndihmës ligjorë;
d) Gjykata e Apelit Korçë – 3 ndihmës ligjorë;
e) Gjykata e Apelit Shkodër – 5 ndihmës ligjorë;
f) Gjykata e Apelit Vlorë – 6 ndihmës ligjorë;
g) Gjykata Administrative e Apelit – 8 ndihmës ligjorë;
h) Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar – 5 ndihmës ligjorë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Naureda Llagami